

PROCESVERBAL
nga seanca e 23-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 05.06.2025

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski, kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini, zëvendëskryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr.Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: Lazar Trajçev.

Në seancë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, Drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishëm nga Shërbimi Profesional: mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, Lucija Gjurmoviç, Maja Damevska, Jeton Ismaili.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, Lazo Petrushevski hapi seancën e 23-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në orën 14:05 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 22-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 30.05.2025.
2. Propozim-rregullore për formën dhe përmbajtjen e aplikimit për regjistrim në Regjistrin e botuesve të medias online – internet portaleve dhe për mënyrën e mbajtjes së Regjistrit të botuesve të medias online – internet portaleve.
3. Propozim - formular për paraqitjen e të dhënave për sigurimin e transparencës në punën e botuesve të mediave online – internet portaleve (formulari SUE/2).
4. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të operatorit TOTAL TV SHPK Shkup, për shkelje të nenit 141 të LSHMAAV.
5. Propozim - vendim për pagesë të kompensimit për vdekjen e anëtari të ngushtë të familjes të punësuar në Agjencion.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar të seancës së 22-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, të mbajtur më 30.05.2025, me tekstin e propozuar.

Pika 2 dhe 3

Z. Trajçevski shpjegoi Projekt-Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e aplikimit për regjistrim në Regjistrin e botuesve të mediave online – internet portaleve dhe për mënyrën e mbajtjes së Regjistrit të botuesve të mediave online – internet portaleve. Ai shpjegoi rrjedhën e debatit publik mbi Projekt-Rregulloren e Punës. Ai informoi se, në përputhje me ndryshimet në Ligjin për Media, Agjencia ka detyrim që në afat prej 30 ditësh të miratojë dy aktet nënligjore. Në këtë drejtim, u zhvillua një debat publik në kohëzgjatje prej 15 ditësh. Në kuadër të debatit publik, u organizua një takim me shumicën e përfaqësuesve të internet portaleve, dhe përveç kësaj, u mbajt një takim tjetër me gjashtë përfaqësues të internet portaleve. Në takim, siç shpjegoi ai, u diskutuan çështje që paraqesin dilema tek pronarët e portaleve në lidhje me mënyrën e përmbushjes së detyrimit ligjor, përkatësisht mundësinë e regjistrimit në Regjistrin e internet portaleve që do të mbahet nga Agjencia. Z. Trajçevski theksoi se në debatin publik morrën pjesë dhe disa nga anëtarët e Këshillit dhe si çështje kryesore u theksua përcaktimi i kodit përkatës të veprimtarisë që duhet të kenë portalet. Në përputhje me Klasifikimin Kombëtar të Veprimtarisë, këto janë kodet 58.12 dhe 58.13, ndërsa shumica e portaleve kanë regjistruar kode të tjera të veprimtarisë nga periudha e mëparshme. Për më tepër, ai informoi se, pas debatit publik të mbajtur me përfaqësuesit të internet portaleve, udhëheqësja Magdalena Dovleva, ka realizuar një takim me përfaqësues të Regjistrit Qendror. Bazuar në konkluzionet nga ky takim, dolën disa ndryshime të cilat janë përfshirë në Propozim-rregullore. Ajo shpjegoi me propozim aktvendimin është lënë mundësia që botuesit ekzistues të internet portaleve, të cilët në momentin e krijimit të Regjistrit kanë një kod kryesor të ardhurash të ndryshëm nga veprimtaria "publikimi i përmbajtjeve informuese, edukative dhe argëtuese në formën e tekstit, formateve audio dhe audiovizuale", që të regjistrojnë aktivitetin përkatës jo më vonë se 31 marsi i vitit pasardhës, pas dorëzimit të llogarisë përfundimtare, me kusht që në aktin themelues të përfshihet një klauzolë e përgjithshme biznesi. Nëse ndonjë botues është i interesuar ta bëjë këtë menjëherë, mund ta bëjë, por z. Trajçevski theksoi se për këtë procedurë paraqiten shpenzime financiare shtesë për shkak të nevojës për të punësuar një revizor të pavarur. Si një mundësi e dytë, dhe në veçanti për radiot sepse nuk përfshihen nga detyrimi në përputhje me Ligjin për Media, ai theksoi mundësinë e hapjes së një dege me kodin 58.12 ose 58.13, me qëllim që portalet ditore të regjistrohen në Regjistrin që mbahet nga Agjencia. Një mundësi e tretë është menjëherë pas dorëzimit të llogarisë përfundimtare të kryhet regjistrimi i veprimtarisë përkatëse me kod 58.12 ose 58.13, jo më vonë se 31 mars, duke pasur parasysh që llogaritë përfundimtare dorëzohen deri më 28 shkurt. Në fjalën e tij, z. Trajçevski informoi se në takime ka pasur një konsensus të përgjithshëm dhe pranim të këtyre propozimeve nga përfaqësuesit e pranishëm të internet portaleve. Vërejtja e vetme ishte se ekzistonte mundësia e një reagimi të mundshëm nga sindikata nëse të gjitha portalet, përfshirë ato më të mëdhatë, do të regjistrohen si subjekte të vogla me vetëm një punonjës. Megjithatë, sipas bisedave me pronarët e portaleve, u përcaktua se ata kanë më shumë të punësuar dhe nuk po mendojnë në atë drejtim. Shumica e tyre informuan se kanë së paku pesë të punësuar dhe nuk do të angazhohen në aktivitete të tilla.

Kryetari i Këshillit, z. Lazo Petrushevski, falënderoi për prezantimin dhe theksoi se ndryshimi që u bë është vërtet për t'u përshëndetur. Ai theksoi se vërejtjet kryesore të bëra nga drejtori ishin pikërisht në këtë drejtim dhe shprehu kënaqësinë që zgjidhja ishte cilësore dhe mirë e pranuar nga palët e interesuara. Ai theksoi se do ta mbështesë propozimin dhe shprehu kënaqësinë që mediat përfundimisht do të përfshihen në formë të caktuar në kuadrin ligjor — pa detyrime të tepërta, por me mundësinë që të dihet struktura e pronësisë. Ai theksoi se kjo është veçanërisht e rëndësishme nga disa aspekte, kryesisht në aspektin e parandalimit të gjuhës së urrejtjes dhe në rastet kur ekziston mundësia e përfitimeve financiare bazuar në aktivitetet zgjedhore.

Z. Trajçevski theksoi se po i referohej dy pikave të rendit të ditës - pika 2 dhe pika 3. Ai vuri në dukje se nuk kishte ndryshime në lidhje me tekstet, por se diskutimin e drejtoi për të dy pikat së bashku, sepse ato janë të lidhura.

Kryetari i Këshillit, z. Lazo Petrushevski, theksoi se nga ana e tij, diskutimi iu referua të dy pikave, duke theksuar se ato janë të lidhura dhe se nuk kishte dallime të rëndësishme midis tyre.

Z. Fidanoski menjëherë në fillim deklaroi se do ta mbështesë Rregulloren e propozuar. Ai theksoi se kjo tregon transparencën e Agjencisë, për të përmbushur nevojat e medias në mënyrën më të plotë të mundshme, duke theksuar se, sipas mendimit të tij, termi "media online" do të ishte i përshtatshëm, megjithëse Ligji përdor formulimin "internet portale". Ai shtoi se kjo është një temë për një diskutim të veçantë, duke pasur parasysh se formulimi ekzistues nuk është plotësisht i përshtatshëm për situatën reale. Ai theksoi se me këtë Rregullore u jep mediave një periudhë prej afërsisht nëntë muajsh për t'u harmonizuar me kushtet ligjore dhe për t'u regjistruar në regjistrin. Ai theksoi se nuk ka sanksione ligjore nëse nuk kryhet regjistrimi, por se kjo do të jetë çështje prestigji dhe besueshmërie midis mediave online, që do të jetë një motiv shtesë për shumicën prej tyre që të vazhdojnë me regjistrim. Ai gjithashtu tregoi se pret që mediat e regjistruara në të ardhmen të kenë përfitime të caktuara në segmente të tjera, kryesisht në punën ekonomike. Ai informoi se personalisht ishte i pranishëm në takimin me përfaqësuesit e mediave online, gjatë të cilit u vërtetua se ekziston interes pozitiv dhe gatishmëri. Lidhur me dy opsionet e propozuara për harmonizim me regjistrin, z. Fidanoski vlerësoi se janë të pranueshme, edhe pse disa nga përfaqësuesit shprehën frikë për rritjen e mundshme të shpenzimeve nëse do të vendosnin për variantin e dytë, duke hapur një degë. Ai shtoi se, sipas informacionit të marrë, këto shpenzime nuk janë të larta dhe se mediat mund t'i përballojnë pa pasoja të mëdha ndaj të punësuarve. Në fund, ai shprehu besimin se zgjidhja e propozuar do të realizohet me sukses dhe se shoqëria mediatike në hapësirën online do të jetë e kënaqur, duke marrë parasysh se në këtë mënyrë do të përmbushet detyrimi ligjor.

Z. Petrushevski konstatoi se nuk kishte të paraqitur për diskutim dhe propozoi që të kalohet në votim për të dyja pikat e rendit të ditës.

Votimi për pikën 2

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e aplikimit për regjistrim në Regjistrin e botuesve të mediave online-internet portaleve dhe për mënyrën e mbajtjes së Regjistrit të botuesve të mediave online-internet portaleve, me tekstin e propozuar.

Sektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Rregulloren e lartpërmendur ta publikon në Gazetën Zyrtare të RMV-së dhe në ueb faqen e Agjencisë.

Votimi për pikën 3

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Aplikimin për paraqitjen e të dhënave për sigurimin e transparencës së punës së botuesve të mediave online – internet portaleve, me tekstin e propozuar në materiale.

Sektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Aplikimin e lartpërmendur, ta publikon në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 4

Z. Trajčevski shpjegoi Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike të operatorit Total TV për shkelje të nenit 141 të LSHMAAV. Ai shpjegoi se në përputhje me gjetjet nga Raporti për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, ky operator ritransmeton disa kanale që nuk mbulohen nga çertifikata e regjistrimit. Meqenëse këtë shkelje e kryen për herë të parë këtë vit është propozuar që të ndërmerret masë vërejtje publike, dhe urdhërohet menjëherë që t'i mbyllë shërbimet programore të huaja që ai ritransmeton pa çertifikatë regjistrimi.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, nr.11-2296/1 datë 02.06.2025 dhe njëzëri konkludoi që Shoqërisë për Tregti dhe Shërbime TOTAL TV SHPK Shkup, t'i shqiptoi masë vërejtje publike për shkelje të nenit 141 paragrafi 13 të LSHMAAV dhe në përputhje me pikën 8 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (tekst i pastruar) nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, urdhërohet menjëherë pas pranimi të Aktvendimit për vërejtje publike të harmonizon punën e tij me LSHMAAV.

Nga mbikëqyrja u konstatua se Shoqëria për Tregti dhe Shërbime TOTAL TV SHPK Shkup, e cila sipas njoftimit nga AKE mund të kryejë veprimtari në territorin e RMV-së, me datë 02.06.2025, për shfrytëzuesit e tij ka ritransmetuar shërbimet programore "TV Sonce", "Insajder TV", "TV Diva", "Sci Fi", "Sport Klubi HD", "Sport Klubi 1", "Sport Klubi 2", "Sport Klubi 3", "Sporti Fight", "SK Golf", "SK Esports", "Nick Junior", "Nikelodeon", "Da Vinci", "Entertainment", "TVM", "TVM '00", "TVM Hits", "Klubi TVM", "TVM '80" dhe "TVM Live", të cilat nuk mbulohen nga çertifikata për regjistrim të shërbimeve programore të dhënë nga Agjencia, që është në kundërshtim me nenin 141 paragrafi 13 të LSHMAAV.

Sektori për çështje juridike të përgatisë Aktvendimin për shqiptimin e masës vërejtje publike për operatorin në fjalë.

Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit, pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike të kryejë mbikëqyrje kontrolli, me qëllim që të përcaktojë nëse subjekti i mbikëqyrjes (operatori) ka vepruar sipas masës së shqiptuar.

Sektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e lartpërmendur ta publikon në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 5

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratim për pagesën e ndihmës financiare - kompensim për vdekjen e anëtarit të familjes së ngushtë - prindit (nënës), në shumë prej dy pagave

mesatare neto mujore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përkatësisht 87.246,00 (tetëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e dyzet e gjashtë) denarë.

Mjetet e mësipërme janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2025.

Përktheu: Antoneta Shabani

**Агенција за аудио и аудиовизуелни
Медиумски услуги
Претседател на Советот**

**_____ — _____
м-р Сашо СТЕФАНОВСКИ**